

Data: 31 . 08 .2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Hartimi i projektit për Riforcimin e njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Tiranë”.

Lloji i procedurës së prokurimit: **“Tender i Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar”**
(Marrëveshje Kuadër - në kuadër të procesit të rindërtimit).

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71221000-3
Shërbim për projektim**

Studim i realizueshmerise, shërbime konsulence, analiza

VLERA E FONDIT LIMIT: 130,478,230 (njëqind e tridhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë pa tvsh

Ne mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 “Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine e Ligjit, Nr.9, date 16.12.2019, të Keshillit të Ministrave, “Per perballimin e pasojave të fatkeqesise natyrore” , Vendimit **Nr. 225, date 12.04.2021** “Per miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, pune, shërbime për procedurë e prokurimit “Procedurë e përsheptuar”, për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentat standarte të tenderit “Procedurë e përsheptuar Shërbime” dhe konkretisht të llojit “Tender i Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar” në kuadër të rindërtimit” të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 (në fazën e dytë);

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4 (në fazën e dytë);

c. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5; (në fazën e dytë);

ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 10;

e. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.

f. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, aktin normativ nr.9 date 16.12.20219 “Per perballimin e pasojave te fatkeqsise natyrore” si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

Kërkesat e pikës 1, janë përcaktuar sipas Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe Dokumenteve Standarte të miratuara nga Agjencia e prokurimit Publik.

Kërkesa e germës “ë” për disponim të dokumentit “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri” vendoset sipas përcaktimeve të nenit 26, pika 7, germa “c” të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” (e ndryshuar) ku citohet se: “Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 13.

Kjo pikë përmbushet sipas pikës) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 "Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 "Për miratimin e dokumentave standarte".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësia Administrativeose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe referuar legjislacionit në fuqi për taksat dhe tarifatat vendore dhe konkretisht ligjit Nr 9632 dt 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar me Ligjin, Nr.142/2015.

2. Operatori Ekonomike duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve pozitive të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2019,2020, 2021) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse, ne te cilat duhet te rezultojë se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te njepasnjeshem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

3. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Referuar VKM nr. 285 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 3.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar te ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet .

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimit, formularin/vërtetimin e vlerësimit për realizimin e shërbimit, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimit të realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe shërbimi i realizuar.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$40\% \times 130,478,230 = 52,191,292$ (pesedhjetë e dy milion e njeqind e nentedhjetë e një mijë e dyqind e nentedhjetë e dy) lekë pa tvsh

Vlera e parashikuar e kontrates është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, përben një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontrates.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Gjithashtu kërkesa e pikes 2.3 është përcaktuar në mbështetje me legjislacionin e sipërpermendur dhe në përmbushje të parashikimit të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e

pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 41, pika 1, gërma b “**Nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë**”.

3 Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

- 2/a- Projektim arkitekturor për objekte banimi- objekte industriale- objekte turistike
- 3-a- Objekte civile- industriale turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
- 3/b-1-Objekte civile-industrial-turistik mbi 5 kate
- 3/d- Vlerësimi I kapacitetit mbajtës dhe përforcimi I strukturave mbajtëse prej beton-arme, muraturë dhe metalike
- 4-a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare
- 4-c-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial
- 8/a -Rilevime inxhinierike
- 9/a Studim/ vleresim gjeologo inxhinierik I truallit për objektet civile – ekonomike deri 5 kate
- 9/b- studim /gjeologo – inxhinierik I truallit për objektet civile- ekonomike mbi 5 kate
- 12/b – Studim/vlerësime gjeologo- sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore, Infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.943, date 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

<i>KATEGORIA E KERKUAR</i>	<i>PERSHKRIMI I KATEGORISE</i>
2 a	Projektim arkitekturor për objekte banimi -objekte industriale - objekte turistike
3-a	Objekte civile- industriale turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
3/b-1	Objekte civile-industrial-turistik mbi 5 kate
3/d	Vlerësimi I kapacitetit mbajtës dhe përforcimi I strukturave mbajtëse prej beton-arme, muraturë dhe metalike
4-a	Projektim të instalimeve hidro-termosanitare
4-c	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial
8/a	Rilevime inxhinierike
9/a	Studim /gjeologo – inxhinierik I truallit për objektet civile-ekonomike mbi 5 kate
12/b	Studim/vlerësime gjeologo- sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore, Infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj

4.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf kryesor inxhinierik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht :

- Projektues Arkitekt (minimum 1)
- Projektues Inxhinier Konstruktor (minimum 1)
- Projektues Inxhinier Elektrik (minimum 1)
- Projektues Inxhinier topograf (minimum 1)
- Projektues Inxhinier gjeolog (minimum 1)

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë staf mbështetës të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, licensë individuale profesionale; diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

Projektues Arkitekt (minimum 1)
Projektues Konstruktor (minimum 1)
Projektues Inxhinier Mekanik (minimum 1)

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me shërbimin e

kryerjes se aktekspertizes dhe projektimit ne ndertesa,prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve ;

6.Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").*

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

7. Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një certificate ISO 9001 -2015 (e vlefshme) për menaxhimin e cilësisë lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim. (Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatë OHSAS 18001-2007, ekuivalente ISO 45001-2018 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim (Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vëndndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si projektues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

9. Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjetë)** personave, për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar tek faktorët, kategoritë e shërbimit, kualifikimi i punonjësve, etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.